

Nr. Prot. 044/B/22

VENDIM Nr. 1972

Për

Miratimin e Raportit për Analizën e Tregjeve 3a dhe 3b

Në mbështetje neni 1, neni 10 paragrafi 5) neni 31, paragrafi 1) paragrafi 3.3) dhe paragrafi 4.3), nenit 79 paragrafët 1) dhe 2) të Ligjit për Komunikimet Elektronike Nr. 04/L-109 (*tutje referuar si – Ligji ose LKE*) dhe nenit 13 paragrafi 1) dhe 5) i Statutit të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (*tutje referuar si – Autoriteti ose ARKEP*), Bordi i Autoritetit i përbërë nga:

- | | |
|-----------------------------|---------|
| 1) z. Nazim Rahimi | Kryetar |
| 2) znj. Lule Ahmedi | Anëtare |
| 3) z. Shkumbin Hamiti | Anëtar |
| 4) z. Rrezarta Duraku-Rizaj | Anëtare |
| 5) z. Arijan Qorolli | Anëtar, |

në mbledhjen e 14-të me radhë të mbajtur më datë 13 Maj 2022, pas shqyrtimit të draft Raporti për Analizat e Tregut dhe rekomandimit të Departamentit të Komunikimeve Elektronike (DKE) dhe Departamentit Ligjor (DL), vendosi si më poshtë:

V E N D I M

- I. Miratohet dokumenti “**Raporti për Analizën e Tregjeve me shumicë: Qasja lokale e ofruar në një lokacion fiks (tregu 3a); dhe Qasja në nivel qendror e ofruar në lokacionin fiks për produktet e tregut masiv**” .
- II. Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

A R S Y E T I M

Neni 1 i Ligjit specifikon qëllimin e Ligjit si në vijim:

“Qëllimi i këtij ligji është rregullimi i aktiviteteve të komunikimeve elektronike bazuar në parimin e neutralitetit teknologjik dhe kornizën rregullatore të BE-së për komunikimet elektronike, duke promovuar konkurrencën dhe infrastrukturën efikase në komunikimet

Faqe 1 nga 2

elektronike, si dhe garantimin e shërbimeve të duhura e të përshtatshme në territorin e Republikës së Kosovës.”

Bazuar, në dispozitën e nenit 30 paragrafi 1 i Ligjit përcaktohet që: ndërmarrësi do të konsiderohet që ka fuqi të ndjeshme tregu (FNT) nëse ai, ose bashkë me të tjerët ka një pozitë ekuivalente mbizotërimi, ose një pozitë të forcës ekonomike që i jepë fuqi që të veprojë në nivel të konsiderueshëm në mënyrë të pavarur nga konkurrentët, klientët dhe shfrytëzuesit fundor.

Kurse, neni 31 paragrafi 4) i Ligjit përcakton që analiza e tregut përfundon me imponimin, korrigjimin dhe/ose anulimin e detyrimeve rregullatore.

Draft Raporti i analizës së tregjeve 3a dhe 3b së bashku me draft vendimet përkatëse, në përputhje me nenin 82 të Ligjit ka kaluar në procedurën e konsultimit publik.

Andaj, Bordi i Autoritetit ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshilla Juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimin të Vendimit.

Prishtinë, 04/07/2022

Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare

Nazim Rahimi
Kryetar i Bordit

Aktvendimi i dërgohet:

- Ofruesve të shërbimeve të Komunikimeve Elektronike
- Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik (MZHE),
- Autoritetit Kosovar të Konkurrencës (AKK),
- Arkivës së Autoritetit.